



REPUBLIKA E SHQIPËRIË
MINISTRIA E KULTURËS

KËSHILLI KOMBËTAR I ARKEOLOGJISË

Nr. 1312 Prot.

Tiranë, më 28.12 2016

VENDIM Nr. 150, datë 20.12.2016

Në mbështetje të Ligjit nr. 9048, datë 07.04.2003, "Për Trashëgiminë Kulturore" (i ndryshuar), VKM Nr. 725, datë 21.05.2008 "Për përbërjen, funksionimin, kompetencat dhe mënyrën e shpërblimit të anëtarëve të Këshillit Kombëtar të Arkeologjisë" (i ndryshuar), Këshilli Kombëtar i Arkeologjisë në mbledhjen Nr. 14 të datës 20.12.2016, pasi shqyrtoi Relacionin mbi verifikimet në terren të gjetjeve arkeologjike të konstatuara gjatë zbatimit të punimeve të *projektit "Ndërhyrje restauruese në Apoloni, Buleterioni", në Parkun Arkeologjik Apoloni, Fier*, realizuar nga Agjencia e Shërbimit Arkeologjik,

VENDOSI:

1. Shoqëria e licencuar në arkeologji "AD-STAR" sh.p.k., të kryejë dokumentimin e strukturave arkeologjike brenda Buleterionit, të konstatuara gjatë zbatimit të punimeve të *projektit "Ndërhyrje restauruese në Apoloni, Buleterioni", në Parkun Arkeologjik Apoloni, Fier*. Raporti i tyre të paraqitet në KKA e radhës.
2. Kjo shoqëri të marrë masat për konservimin *in situ* të këtyre strukturave, me qëllim ruajtjen e tyre nga dëmtimet atmosferike të kohës.
3. Projekti për restaurimin e tyre të shqyrtohet nga Këshilli Kombëtar i Restaurimeve.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.
5. Ngarkohet Sekretaria Teknike për njoftimin e këtij vendimi.

KRYETAR
MIRELA KUMBARO FURXHI
MINISTËR



SEKRETAR I KKA
RUDINA ZOTO